



06/07/2026

02/806

Duke u Bazuar në:

Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) – NR.32/2024 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2024;

Thirrjen për Aplikim për Masën 5 – Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – qasja LEADER për GLV-të e përzgjedhura për përkrahje me Programin e Zhvillimit Rural 2024, e shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ["MBPZHR"];

Vendimin/Miratimin e MBPZHR-së për projektin "Zbatimi i Strategjisë Zhvillimore Lokale" për GLV "Natyra" – Shtime, në kuadër të Masës 5 – Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale – Qasja LEADER për grupet lokale të veprimit (GLV) të përzgjedhura – 2024, të datës 30.09.2025;

Kontratën për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural Nr.470/2025, të lidhur më 30.09.2025 në Prishtinë ndërmjet Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë në kuadër të MBPZHR-së dhe GLV "Natyra", Komuna e Shtimes.

Palët kontraktuese (në tekstin në vijim: "Palët kontraktuese");

Komuna e Shtimes, e përfaqësuar nga Kryetari, z. Qemajl Aliu (në tekstin e mëtejshëm: "Komuna e Shtimes"); dhe

Grupi Lokal i Veprimit "NATYRA", Komuna e Shtimes, me numër unik të Identifikimit në Regjistrin e Fermerëve 1014381, e përfaqësuar nga Kryetari, z. Ejup Adem Ismajli (në tekstin në vijim: "GLV Natyra").

Duke njohur të drejtat dhe obligimet e tyre,

Lidhin këtë:

MARRËVESHJE PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella ndërmjet Komunës së Shtimes dhe GLV Natyra, për financimin, zbatimin dhe monitorimin e nënprojektit "Tribunat tek fusha e futbollit në Llanishtë dhe Organizimi i Panairit të Prodhimeve Bujqësore në Shtime", i cili zbatohet në kuadër të projektit "Zbatimi i Strategjisë Zhvillimore Lokale", të financuar në bazë të Kontratës për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr.470/2025, të lidhur ndërmjet MBPZHR-së dhe "GLV Natyra".

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të sigurojë bashkëfinancimin e nënprojektit nga Komuna e Shtimes, në cilësinë e donatorit, në përputhje me Programin e Zhvillimit Rural 2024, Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) nr.32/2024 dhe Kontratën për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr.470/2025, si dhe të përcaktojë mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet palëve kontraktuese për realizimin e suksesshëm të nënprojektit, administrimin e mjeteve financiare dhe përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga aktet ligjore përkatëse.

Neni 3

Vlera e nënprojektit dhe bashkëfinancimi

1. Vlera totale për realizimin e nënprojektit "Tribunat tek fusha e futbollit në Llanishtë dhe Organizimi i Panairit të Prodhimeve Bujqësore në Shtime", i cili zbatohet në kuadër të projektit "Zbatimi i Strategjisë Zhvillimore Lokale", është 10,998.00 euro.
2. Financimi i nënprojektit sigurohet si në vijim:
 - 2.1.1 80 përqind e vlerës totale, në shumën prej 8,798.40 euro, financohet nga GLV Natyra, prej fondeve të administruara nëpërmjet Programit të Zhvillimit Rural 2024, në bazë të Kontratës për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr.470/2025.

- 2.1.2 20 përqind e vlerës totale, në shumën prej 2,199.60 euro, sigurohet nga Komuna e Shtimes, në cilësinë e bashkëfinancuesit (donatorit), në përputhje me këtë Marrëveshje.
3. Mjetet e bashkëfinancimit të siguruara nga Komuna e Shtimes do të përdoren ekskluzivisht për realizimin e nënprojektit të përcaktuar në këtë Marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Në rast të përdorimit të mjeteve në kundërshtim me këtë Marrëveshje ose me legjislacionin në fuqi, GLV Natyra obligohet t'ia kthejë Komunës së Shtimes shumën përkatëse, brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim.

Neni 4

Obligimet e GLV Natyra

1. GLV Natyra obligohet që:
- 1.1 Të zbatojë nënprojektin në përputhje me Kontratën për Financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural nr.470/2025, si dhe aktet ligjore në fuqi.
- 1.2 Të zhvillojë dhe të administrojë procedurat për realizimin e nënprojektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e Programit të Zhvillimit Rural.
- 1.3 T'i përdorë mjetet financiare të siguruara nga MBPZHR dhe bashkëfinancimin e Komunës së Shtimes vetëm për realizimin e nënprojektit sipas buxhetit të miratuar.
- 1.4 Të mbajë evidencë të plotë financiare dhe dokumentacionin përkatës për realizimin e nënprojektit.
- 1.5 Të informojë Komunën e Shtimes për ecurinë e realizimit të nënprojektit, dhe pas përfundimit të tij, t'ia dorëzojë raportin përfundimtar së bashku me dokumentacionin përcjellës, brenda 15 ditëve nga përfundimi i projektit.
- 1.6 Të njoftojë menjëherë Komunën e Shtimes për çdo ndryshim të projektit.
- 1.7 Të mundësojë qasjen në dokumentacionin që lidhet me realizimin e nënprojektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për qasjen në dokumente zyrtare.

Neni 5

Obligimet e Komunës

1. Komuna e Shtimes obligohet që:

- 1.1 Të sigurojë bashkëfinancimin e nënprojektit në shumën e përcaktuar në këtë Marrëveshje.
- 1.2 Të transferojë mjetet e bashkëfinancimit në llogarinë bankare të GLV Natyra, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.
- 1.3 Të bashkëpunojë me GLV Natyra gjatë realizimit të nënprojektit, në funksion të përmbushjes së tij.
- 1.4 Të monitorojë realizimin e nënprojektit dhe kur është e nevojshme, të kërkoj informata ose dokumentacion lidhur me përdorimin e mjeteve të bashkëfinancimit.
- 1.5 Të kërkojë korrigjimin e parregullsive dhe në rast nevojë, kthimin e mjeteve të bashkëfinancimit në përputhje me këtë Marrëveshje.

Neni 6

Mënyra dhe afati i transferimit të mjeteve

1. Mjetet e bashkëfinancimit në shumën prej 2,199.60 euro transferohen në llogarinë bankare të GLV Natyra, sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
2. Transferimi i mjeteve në llogarinë bankare të GLV Natyra bëhet brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e Kësaj Marrëveshjeje, si dhe pas dorëzimit të kërkesës për pagesë dhe dokumentacionit përkatës nga GLV Natyra.

Neni 7

Raportimi dhe monitorimi

1. GLV Natyra do t'i raportojë në mënyrë të rregullt dhe periodike Komunës së Shtimes në lidhje me realizimin e aktiviteteve për përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje, sipas obligimeve që dalin nga neni 4 i Marrëveshjes.
2. Komuna e Shtimes mund të kërkojë në çdo kohë qasje në dokumentet relevante të realizimit të nënprojektit, si dhe të kryejë vizita monitoruese në vendin e realizimit të nënprojektit gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

3. GLV Natyra mban përgjegjësi të plotë civile, administrative dhe penale për saktësinë e dokumentacionit dhe deklarimeve të paraqitura gjatë realizimit të nënprojektit.

Neni 8

Ndryshimi i marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me aneks me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët kontraktuese.
2. Aneksi i Marrëveshjes nuk mund të ndryshojë kushtet esenciale të parashikuara në Marrëveshjen fillestare.

Neni 9

Shkëputja e marrëveshjes

1. Komuna e Shtimes e mban të drejtën që të shkëpusë Marrëveshjen në çdo rast kur GLV Natyra nuk vepron në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, sidomos në çështjet që prekin drejtpërdrejtë realizimin e nënprojektit dhe administrimin e fondeve të pranuar nga Komuna e Shtimes.
2. Shkëputja e Marrëveshjes bëhet me njoftimin zyrtar ndaj palës tjetër dhe prodhon efekte juridike që në momentin e pranimin të njoftimit.

Neni 10

Kthimi i mjeteve

1. Nëse fondet e pranuar përdoren në kundërshtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, GLV Natyra obligohet t'ia kthejë Komunës së Shtimes shumën përkatëse brenda 30 ditëve nga dita e pranimin të kërkesës me shkrim.
2. Komuna e Shtimes do të kërkojë çdo kompensim dëmi eventuale nga keqmenaxhimi dhe përdorimi jo i duhur i mjeteve financiare sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët kontraktuese do të përpiqen fillimisht t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me marrëveshje ose me ndërmjetësim. Nëse kjo nuk është e mundur, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata Themelore në Ferizaj.

Neni 12

Kohëzgjatja

1. Marrëveshja mbetet në fuqi deri në përmbushjen e plotë të obligimeve të palëve kontraktuese.

Neni 13

Komunikimi

1. Palët kontraktuese do të komunikojnë dhe bashkëpunojnë për zbatimin e kësaj Marrëveshje menjëherë pas hyrjes në fuqi të saj.
2. Të gjitha njoftimet ndërmjet palëve kontraktuese do të bëhen me shkrim, përmes emailit apo çdo forme tjetër zyrtare.

Neni 14

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët kontraktuese.

Për Komunën e Shitimes

Kryetari, z. Qemaj Aliu



Për GLV Natyra

z. Ejup Ismajli

